



Newsletter

STRONG ALBANIAN LOCAL STATISTICS

Prill - Shtator 2025

Projekti “Statistika të Forta Vendore Shqiptare” (SALSTAT II) është pjesë e nismës “Bashki të Forta”, financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) që zbatohet në periudhën tetor 2022 - shtator 2026.

Palët kyç të interesit të projektit SALSTAT, përfshijnë INSTAT-in, bashkitë, si dhe disa ministri të linjës e agjenci qeveritare, veçanërisht ato të përfshira mbledhjen e të dhënave statistikore dhe/ose përgjegjëse për të dhënat dhe regjistrat administrativë.

Gjatë kësaj faze të re, SALSTAT II do të thellojë bashkëpunimin me bashkitë dhe agjencitë e tjera qeveritare me qëllim mëkimin e besimit në statistikën zyrtare. Gjithashtu, projekti do të angazhojë palët e interesit në lidhje me rëndësinë e statistikave zyrtare për qeverisjen demokratike dhe vendimmarrjen e informuar, veçanërisht duke mbështetur bashkitë në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tyre, dhe me vendimmarrjen veçanërisht në kuadër të përmbushjes së detyrave dhe funksioneve të bashkive.

EKIPI I SALSTAT

Menaxher projekti:

Martin Teichgräber, Zyra Federale Zvicerane e Statistikave

Koordinatorë:

Alketa Doçi, Koordinatorë për Regjistrat dhe të Dhënat Administrative
Eralda Pushaj, Koordinatorë me Njësitë e Qeverisjes Qendrore
Edlira Çeliku, Koordinatorë Administrative dhe Financiare

Përmbajtja:

- Analizimi i të dhënave të Censurit për bashkitë;
- Shpërndarja e Vjetarit Statistikor në qarqe dhe në bashki;
- Zhvillimi i mjeteve të shpërndarjes digjitale për publikimin e të dhënave statistikore për qarqet dhe bashkitë;
- Shkëmbimet me palët e interesit për krijimin e besimit lidhur me statistikën në nivel vendor;
- Grupi i punës INSTAT/SALSTAT dhe Ministrisë së Shtetit për Vetëqeverisjen Vendore;
- Vlerësimi për një regjistr të mundshëm të mundshëm të popullsisë dhe njësive ekonomike familjare dhe përdorimit të tij për qëllime statistikore;
- Regjistri Statistikor Shqiptar i Ndërtesave dhe Banesave;
- Trajnimi në vazhdim dhe mbledhja e të dhënave për Anketën e Mbetjeve Familjare 2024;
- Mbledhja e të dhënave e bazuar në rrjet për statistikën e lejeve të ndërtimit;
- Statistikat e pyjeve (fushë e re statistikore);
- Trajnimi i stafit të INSTAT-it për gjuhën R për anketën me kampion;
- Trajnimi për statistikën jetësore përmirëson cilësinë e të dhënave në Shqipëri;

Analizimi i të dhënave të Censurit për bashkitë

Në qershor të vitit 2025, INSTAT-i shpërndau volumet e shtypura të të dhënave të Censurit të vitit 2023 në të 61 bashkitë e vendit nëpërmjet postës. Kjo nismë pati si synim garantimin e qasjes së drejtpërdrejtë për njësitë e qeverisjes vendore në statistika demografike dhe socio-ekonomike gjithëpërfshirëse për qëllime planifikimi dhe vendimmarrjeje.

<https://www.instat.gov.al/sq/temat/censet/censet-e-popullsise-dhe-banesave/publikimet-cesnsusi-i-popullsise-dhe-banesave/2023/publikimet-e-censit-te-popullsise-dhe-banesave-2023/>



Shpërndarja e Vjetarit Statistikor në qarqe dhe në bashki

Gjatë periudhës së raportimit, INSTAT-i ka publikuar versionin shqip dhe anglisht të Vjetarit Statistikor Rajonal (VSR) 2024. Lidhjet për versionin shqip dhe anglisht të VSR-së u ndanë me të gjitha palët e interesit.

[vjetari-statistikor-rajonal-2024.pdf](#)

[regional-statistical-yearbook-2024-fin.pdf](#)

Zhvillimi i mjeteve të shpërndarjes digjitale për publikimin e të dhënave statistikore për qarqet dhe bashkitë

INSTAT-i ka punuar nga afër me ekspertët për të zhvilluar një panel të sigurt dhe të bazuar në rrjet për publikimin e të dhënave statistikore për qarqet dhe bashkitë. Platforma e re është projektuar për të ofruar një përvojë miqësore për përdoruesin dhe për të mundësuar qasje të përditësuar në të dhënat e Censurit 2023 dhe në statistika të tjera vendore.

Në seminarin e mbajtur në muajin maj 2025 u prezantua paneli dhe GeoData Hub, Web GIS dhe Story Maps, duke paraqitur mjetet për vizualizimin dhe raportimin e shpejtë lidhur me situatën. U paraqitën gjithashtu edhe treguesit në nivel bashkie prej Vjetarit Statistikor Rajonal.



INSTAT-i vijon ta popullojë platformën GeoData Hub me të dhënat e Censurit dhe Vjetarit, ndërsa vazhdon optimizmin e panelit të saj. Platformat GeoData Hub, Web GIS dhe Story Maps mund t'i gjeni në lidhjet vijuese:

[Platforma GeoData Hub e INSTAT-it](#)
[Web GIS | Platforma GeoData Hub e INSTAT-it](#)
[100 vite Census në Shqipëri](#)

Në gusht 2025, u mbajt një takim në kuadër të sinergjisë ndërmjet dy projekteve, SALSTAT-it dhe HELVETAS-it. Gjatë këtij takimi, u vendos theksi te zbatimet praktike të panelit dhe te vlera e tij për përpjekjet për zhvillim. Versioni përfundimtar i panelit pritet të vendoset në zbatim në fund të vitit 2025.



Shkëmbimet me palët e interesit për krijimin e besimit lidhur me statistikën në nivel vendor

Në muajin korrik 2025, projekti SALSTAT bashkëpunoi me një ekspert vendor për të vizituar shtatë bashki: Tropojë, Lezhë, Shkodër, Kavajë, Berat, Vlorë dhe Himarë. Vizitat synuan ndërtimin e besimit të statistikave vendore dhe eksplorimin e treguesve të rinj, veçanërisht në sektorin e turizmit, ku kërkesa e publikut për të dhëna po vjen duke u rritur.



Rekomandimet e ekspertit për forcimin e statistikave për turizmin:

- Të krijohen Strategji Vendore për Turizmin, të bashkërenduara me planin kombëtar dhe që përfshijnë objektiva për të dhënat
- Të krijohen platforma digjitale për mbledhjen e të dhënave për turizmin në kohë reale
- Të nxitet bashkëpunimi ndërmjet bashkive, bizneseve turistike dhe agjencive kombëtare
- Të ofrohet trajnim për stafin në sektorin e turizmit lidhur me mjetet dhe planifikimin e të dhënave

- Të trajtohet informaliteti në akomodime nëpërmjet rregulloreve inteligjente
- Të investohet në infrastrukturë, si rrugë, sinjalistikë dhe qendra vizitorësh

Grupi i punës INSTAT/SALSTAT dhe Ministrisë së Shtetit për Vetëqeverisjen Vendore

Gjatë periudhës së raportimit, INSTAT-i zhvilloi takime të rregullta me grupin e punës dhe Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore me qëllim forcimin e bashkëpunimit për statistikat në nivel bashkie.

Ky bashkëpunim synon të sigurojë njëtrajtshmërinë e praktikave të mbledhjes së të dhënave dhe t'i mbështetë bashkitë në përdorimin e mjeteve të standardizuara për raportim statistikor të përmirësuar.

Vlerësimi për një regjistrë të mundshëm të popullsisë dhe njësive ekonomike familjare dhe përdorimit të tij për qëllime statistikore

Në muajin maj 2025, INSTAT-i organizoi një takim përparimor për finalizimin e agjendës për një seminar ndërkombëtar të fokusuar te realizueshmëria dhe planifikimi i një regjistri për popullsinë dhe njësitë ekonomike familjare.

Po në muajin maj, seminari bëri bashkë ekspertë dhe përfaqësues të zyrave statistikore të Kroacisë, Malit të Zi, Estonisë dhe Vendeve të Ulëta. Aktiviteti u fokusua tek organizimi i censuseve, duke u bazuar te të dhënat administrative dhe shqyrtoi:

- Dallimet ndërmjet censuseve të zakonshëm të zhvilluar në terren dhe metodave të bazuara te regjistrat ose ato të ndërthurura
- Përdorimin e burimeve administrative, si regjistrat civilë, të dhënat tatimore, sistemet arsimore dhe sigurimet shoqërore
- Qasjet, sfidat dhe risqet konkrete për vendin sa i përket zbatimit të censuseve të bazuar te regjistrat

Seminari theksoi që, pavarësisht se zhvillimi i një censusi të bazuar plotësisht te regjistrat mund të mos jetë i realizueshëm në Shqipëri brenda vitit 2031, zhvillimi i një censusi të ndërthurur, të bazuar te regjistrat, është një alternativë realiste dhe strategjike.




INSTAT-i organizoi një workshop për përparitjen e një dokumenti strategjik për shqyrtim në Kuvend, ku u përvijua koncepti dhe udhërrëfyesi për Regjistrin e Popullsisë dhe Njësive Ekonomike Familjare. Procesi i hartimit u mbështet nëpërmjet takimeve të rregullta me departamentet ligjore, të TI-së dhe popullsisë të INSTAT-it dhe dokumenti përfundimtar i konceptit pritet të përfundojë në tetor të vitit 2025. Kjo nismë shënon një hap themelor në rrugëtimin e Shqipërisë drejt modernizimit të sistemeve të të dhënave të popullsisë dhe bashkërendimit me praktikën më të mira ndërkombëtare.



Regjistri Shqiptar Statistikor i Ndërtesave dhe Banesave

INSTAT-i, në bashkëpunim me SALSTAT II, vijoi punën në kuadër të Regjistrit Shqiptar Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave (RSHSNB) nëpërmjet një sërë misionesh teknike dhe veprimtarish zhvillimi gjatë vitit 2025.



Në gjysmë të vitit u mbajt një seminar për të shqyrtuar ecurinë e hartimit të Regjistrit Shqiptar Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave. Ky aktivitet bëri bashkë ekspertë teknikë, punonjës të INSTAT-it dhe përfaqësues të institucioneve të përfshira për të diskutuar arkitekturën e sistemit, integrimin e të dhënave dhe planet e ardhshme të zbatimit.

- Shqyrtimi i strukturës TI të regjistrit dhe funksionaliteteve të bazës së të dhënave
- Koordinimi ndërmjet departamenteve për mirëmbajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave
- Planifikimi për punën e ardhshme në terren dhe integrimi në sistemet statistikore më të gjera

INSTAT-i dhe SALSTAT-i planifikojnë ta paraqesin Regjistrin Shqiptar Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave (RSHSNB), duke përfshirë arkitekturën TI, funksionalitetet dhe bazën e tij të të dhënave, në takimin e Grupit Drejtues të planifikuar në muajin nëntor 2025.



Trajnimi në vazhdim dhe mbledhja e të dhënave për Anketën e Mbetjeve Familjare 2024

Në shkurt të vitit 2025, Njësia e Mjedisit dhe Pyjeve në INSTAT shpërndau adresën e internetit për Anketën e Mbetjeve Familjare të vitit 2024 në të 61 bashkitë e vendit.

Gjatë muajit prill, me mbështetjen në terren të stafit të Zyrave Statistikore Rajonale ndaj stafit të dhjetë bashkive (punonjës të rinj), që hasën vështirësi me plotësimin e pyetësorit në internet për mbetjet familjare, u bë e mundur mbledhja e të dhënave për 61 bashkitë.

Pas përgatitjes dhe kontrollit të cilësisë së të dhënave të mbledhura, stafi i INSTAT-it i publikoi ato në muajin shtator 2025.

https://www.instat.gov.al/media/hw2jnxtd/urban-solid-waste-esms_final.pdf

Mbledhja e të dhënave e bazuar në rrjet për statistikën e lejeve të ndërtimit

Në korrik 2025, INSTAT-i dhe SALSTAT-i vijuan përpjekjet e tyre për modernizimin e sistemeve statistikore duke trajnuar stafin e bashkive lidhur me platformën e re të bazuar në rrjet për Statistikën e Lejeve të Ndërtimit.

Seanca u fokusua te:

- Rëndësia e statistikave të lejeve të ndërtimit dhe kuadri ligjor
- Përkufizimet e treguesve kryesorë dhe metodologjia për mbledhjen e të dhënave
- Udhëzime praktike për plotësimin e pyetësorit në internet

Trajnimi u zhvillua në grupe të vogla nga ekspertët pranë Drejtorisë së Statistikave Ekonomike dhe Departamentit të TI-së të INSTAT-it. Në trajnim morën pjesë 35 punonjës nga 23 bashki, 54% e të cilëve ishin gra. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve ishin përgjegjës për mbledhjen e të dhënave për lejet e ndërtimit në nivel bashkie. Lidhja e anketës në internet u shpërnda me të gjitha bashkitë në muajin korrik dhe afati i dorëzimit të të dhënave ishte parashikuar për në fund të po atij muaji. Rezultatet u publikuan në gusht 2025.

Kjo nismë përkrah mbledhjen efikase të të dhënave digjitale dhe forcon kapacitetin vendor për nxjerrjen e treguesve të besueshëm të zhvillimit.



Statistikat e pyjeve (fushë e re statistikore)

INSTAT-i ka ndërmarrë një nismë të re për përpilimin e statistikave të pyjeve dhe kullotave në nivel bashkie. Kjo përpjekje shënon një hap domethënës drejt forcimit të mbledhjes së të dhënave mjedisore dhe decentralizimit të treguesve statistikorë.

Në maj të 2025-s, INSTAT-i miratoi pyetësin përfundimtar dhe krijoi një lidhje për mbledhjen e të dhënave në internet. Gjithashtu, u përgatit edhe një manual trajnimi për stafin e bashkive.



U mbajtën takime koordinimi me projektin SALSTAT dhe Agjencinë Kombëtare të Pyjeve (AKP) për bashkërendimin e përmbajtjes së trajnimit dhe zbatimit të tij.

Në qershor 2025, INSTAT-i organizoi një seancë trajnimi në Tiranë për 63 punonjës të pyjeve nga 42 bashki, bashkërisht me 12 krerë të zyrave statistikore rajonale. Temat kishin të bënin me kuadrin ligjor, përcaktimin e treguesve, Doracakun e Llogarive Pyjore Evropiane (2024) dhe përdorimin praktik të pyetësit në internet.

Lidhja e anketës në internet u shpërnda me të gjitha bashkitë në muajin korrik 2025, me mbështetjen e Drejtorisë për Bujqësinë dhe Mjedisin dhe zyrat statistikore rajonale.



Në shtator, SALSTAT-i dhe AKP-ja ofruan mbështetje në terren në Memaliaj, Delvinë, Himarë, Gramsh, Pogradec, Pustec dhe Peqin.

Të dhënat e 61 bashkive janë mbledhur dhe u janë nënshtruar kontrolleve të cilësisë. Pas përfundimit të procesit do të merret vendimi për publikimin e tyre.

Kjo nismë përfaqëson një përparim madhor sa u përket statistikave mjedisore të Shqipërisë, duke mundësuar informacione më të lokalizuara dhe të zbatueshme për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave.



Trajnimi i stafit të INSTAT-it për gjuhën R për anketën me kampion

Në shtator 2025, INSTAT-i zhvilloi me sukses një seancë trajnimi të fokusuar te metodologjitë e reja për anketat me kampion, të përshtatur për përfaqësuesit rajonalë dhe vendorë. Trajnimi, i mbajtur pranë zyrës qendrore të INSTAT-it, u udhëhoq nga një ekspert i Zyrës Federale Statistikore Zvicerane (FSO) dhe u përqendrua tek analiza statistikore duke përdorur gjuhën R. Kjo nismë synonte të përmirësonte kapacitetin teknik të INSTAT-it për zbatimin e teknikave moderne të anketimit dhe përpunimit të të dhënave, duke lehtësuar nxjerrjen e rezultateve statistikore më cilësore dhe të besueshme në mbarë Shqipërinë.



Trajnimi për statistikave jetësore përmirëson cilësinë e të dhënave në Shqipëri

Si pjesë e MM-së ndërmjet INSTAT-it dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC), në prefekturën e Beratit, Vlorës dhe Elbasanit u mbajt një trajnim rreth statistikave jetësore. Nisma synonte përmirësimin e saktësisë së regjistrimeve të lindjeve, vdekjeve dhe martesave, si dhe njohjen me standardet e kodimit sipas ICD-10-s.

- DPGJC-ja trajtoi sfidat ligjore, mbrojtjen e të dhënave personale dhe risqet e pashtetësisë.
- Trajnuesit analizuan dokumentet e statistikave jetësore të vitit 2024 dhe rekomanduan integrimin e kodit të ICD-10-s për të dhënat e vdekjeve.

Pjesëmarrësit ndanë në mënyrë aktive përvojat e tyre, problematikat e identifikuara të të dhënave dhe morën përsipër të zbatojnë praktika të reja. Kjo seancë dyditore përforcoi rëndësinë e të dhënave administrative të besueshme dhe shënoi një hap para në përpjekjet e Shqipërisë për modernizimin e sistemeve të regjistrimit të gjendjes civile.

✓ Qershor 2025: Prefektura e Beratit (Berat, Kuçovë, Poliçan, Skrapar dhe Dimal)



- ✓ Korrik 2025: Prefektura e Vlorës (Vlorë, Selenicë, Sarandë, Himarë, Finiq, Delvinë dhe Konispol)



- ✓ Shtator 2025: Prefektura e Elbasanit (Elbasan, Peqin, Librazhd, Përrenjas, Gramsh, Belsh dhe Cërrik)



Planifikohet të organizohet trajnim edhe për prefekturat e tjera: Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë gjatë periudhës tetor-dhjetor 2025.

JU FALËNDEROJMË QË LEXUAT BULETININ TONË INFORMATIV!